

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - E HAPUR MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR -
MALLRA**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pompash rezerve për stacionet e pompimit të Rajonit”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV) Pompa Uji
42122130 – 0**

VLERA E FONDIT LIMIT: 32,928,219 (tridhjetë e dy milion e nentëqind e njetëzetë e tete mijë e dyqind e nentëmbëdhjetë) lekë **pa TVSH**

(Per llogaritjen e fondit limit, jemi bazuar ne cmimet njesi te botuara ne internet, ne studimin e tregut nepermjet ofertave dhe te kontratave te meparshme, me Nr. 1097 date 19.12.2024 realizuar nga Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime sarande sh.a).

Vlera e fondit Limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 332,776.34 (Treqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pike tridhjetë e kater) euro euro pa TVSH

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 18.04.2024 është 98.95

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; përkatësisht në vlerën 658,564.38 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër pikë tridhjetë e tete) leke*

Shuma e kerkuar e sigurimit te ofertes ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise 6,655.52 (gjashte mije e gjashteqind e pesedhjetë e pese pike pesedhjetë e dy) euro.

euro. Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 18.04.2025 është 98.95 euro.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023,2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, pika 2, paragrafi c), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022,2023,2024) të çertifikuara nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2024)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësisve vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin. *(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

2.2.4 Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2024 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi. Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në marrëveshjen kuadër dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin

e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate përkatësisht jo më e vogël se 13,171,287.6 (trembedhjetë milion e njëqind e shtatedhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë e shtate pike gjashtë)lekë pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, ose,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 40, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$32.928.219 \times 40\% = 13,171,287.6$ (trembedhjetë milion e njëqind e shtatedhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë e shtate pike gjashtë)lekë pa tvsh.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2. 3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar staf inxhinierik:

- a. 1(nje)inxhinier elektrik
- b. 1(nje)inxhinier hidroteknik
- c. 1(nje)inxhinier materialesh

Inxhinieret e mësipërm duhet të jene te siguruar dhe të figurojnë me kohë të plotë në listëpagesat perkatese E-Sig për të paktën muajin e fundit.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë

Kontratën individuale të punës, Diplomën e inxhinierëve të mësipërm.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Gjithashtu argumentojmë se kemi të bëjmë me kontrata komplekse ku përfshihen blerje mallrash me performancë sipas specifikimeve teknike përkatëse të vendosura ne DST. Dhe si rrjedhim është i domosdoshëm inxhinieri Elektrik për automatik, inxhinieri Hidroteknik dhe ai I materialeve për saktësimin e të gjitha karakteristikave të pompave sipas kërkesave dhe nevojave të autoritetit.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te dëshmoje se ka fuqinë punëtore të nevojshme minimalisht 7 (shtate) punonjës me kohë të plotë pune, për ekzekutimin e objektit të prokurimit, Punonjësit duhet te jene te siguruar te pakten për 3 muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje listpagesat E-Sig te punonjesve te sipercituar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur si më poshtë:

Për të garantuar shërbimet me cilësi dhe për të garantuar sigurinë teknike gjatë ofrimit të mallrave të kërkuar është bërë një shumatore e Inxhinierëve të kërkuar, me drejtuesit e automjeteve që kërkojnë nga kjo procedurë si dhe ekspertët (inxhinierë + manovratorë + shoferë = në total nr punonjësish)

Për llogaritjen e numrit të punonjësve për punimet e rehabilitimit jemi bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të kenë të punësuar stafin teknik të përbërë nga të paktën 2 (dy) punonjës të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë, dhe që duhet të pasqyrohen në listën e pagave të shoqërisë për periudhën e 3 muajve të fundit, duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit. Profesionet përkatëse janë si më poshtë:

2 (dy) shoferë për drejtim mjetesh të pajisur me leje drejtimi me kategorinë "C" dhe / ose "CE" dhe/ose "D" dhe / ose "DE" të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqitet dokumentacioni i mëposhtëm: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, të lëshuara nga institucione publike / private të licencuara sipas Ligjit Nr. 15/2017 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

pjesëmarrës mund t'i disponojë ata edhe të kontraktuar me kontratë pune ose shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit, deri në përfundimin e kontratës.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. "Para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/ enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar të paraqesë dokumentet provuese." Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehësuar me origjinalin.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të paktën:

1 (një) automaknist, i cili mund të jenë pjesë e stafit të brendshëm të kompanisë ose mund të kontraktohen me kontratë pune ose shërbimi, për realizimin e objektit të prokurimit, me afat deri në përfundimin e kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Duke u nisur nga mjetet që janë kërkuar si: kamion me vinç dhe piruni teleskopik është kërkuar një 1 manovrator për kamionin me vinç i vetëm dhe dy shoferë për pirunin teleskopik, pra kemi përcaktuar një numër të nevojshëm manovratorësh dhe shoferësh.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të kenë në stafin e Tij, 1 (një) punonjes që të disponojë certifikatë të trajnimit si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në

punë” i ndryshuar dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" i ndryshuar.

Për pikën si mësipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si mësipër.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues për përmbushjen e kontratës duhet të dëshmojë se ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme, si me poshte vijon:

Nr.	Mjetet	Sasia
1	Kamion me vinç	1 cope
2	Pirun teleskopik MT	1 copë
3	Helmeta	10 copë
4	Tabela të sigurimit teknik	3 copë
5	Kuti e ndihmes së shpejte	1 copë

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr. 9. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, **si më poshtë:**

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: certifikatën e pronësisë; lejen e qarkullimit; certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin që lëshohet nga njësi vendore dhe fotot përkatëse;

Ndërsa për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Kamion me vinq

Nevojitet për transportin dhe vendosjen e paletave të pompave në vendin e përcaktuar sipas kërkesave të autoritetit.

Pirun teleskopik MT

Ky mjet teknologjik nevojitet për transportimin e brendshëm të paletave të mallrave të kërkuar nga autoriteti nga kamioni deri në magazinën/ vendin e përcaktuar sipas kërkesave të vete autoritetit kontraktor.

Helmeta, Tabela të sigurimit teknik, Kuti e ndihmes së shpejte

Pajisjet e mesiperme janë të nevojshme për sigurimin teknik të punonjesve, për kantierin apo vizitoret.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 **(ose ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t'u kërkojë

ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

2.5. Operatori ekonomik duhet te paraqese:

- Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuara. Ne rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit bashkengjitur autorizim (te pajisur me vule apostile, te noterizuar ne rastet kur prodhuesi eshte kompani e huaj).Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

2.6.Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalogun/et të prodhuesit/ve te mallrave objekt prokurimi.Në rast se katalogjet apo broshurat janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar parashikohet shprehimisht.... Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b) fotografitë apo katalogjet teknike

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përpuethshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

2.7.Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik një deklaratë me anë të së cilës duhet të deklarojë se në momentin e dorëzimit të mallit pranë AK do të paraqesë çertifikatën origjinale të origjinës së mallrave ose fotokopje të noterizuar të saj.

2.8.Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në formën e një tablele, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë artikujt e Listës.

Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr	Emertimi i produkteve	Emertimi kompanise prodhuese, adresa , web-siti	Emertimi i katalogut	Referenca ne katallogje/	Shënimet
				KOD I produktit ose nr. Faqes ne katalog	

Emërtimi I produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të paraqitur nga AK.

-Emri, Adresa dhe ëeb-site i kompanise prodhuese ose distributor i autorizuar, me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në ofertim.

-Referenca në katalogje, kodi i produktit të plotësohet (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr,i faqes)duke treguar kodin ose numrin e faqes së katalogut në katalogun përkatës ku AK mund të gjejë specifikimet teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1, si dhe njoftimit të APP-së nr.prot 7459/4, datë 25.05.2021.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike te pompave(blerje):

- Elektropompe zhytесе, $Q = 215 \text{ m}^3/\text{h}$, $H=211 \text{ m}$, P2(fuqia e motorit) jo me shume se 170 kW, Diametri i lidhjes me tubacionin $D = 6''$ (inch, tipi i lidhjes Rp), Diametri i maksimal jo me i madh se $10''$ (inch), $U = 380 \text{ V}$, Vriон.
- Elektropompe zhytесе, $Q = 160 \text{ m}^3/\text{h}$, $H = 30 \text{ m}$, P2(fuqia e motorit) jo me shume se 22 kW, Diametri i lidhjes me tubacionin $D = 6''$ (inch, tipi i lidhjes Rp), Diametri i maksimal jo me i madh se $8''$ (inch), $U = 380 \text{ V}$, Cuke
- Elektropompe horizontale, $Q = 24 \text{ m}^3/\text{h}$, $H = 73 \text{ m}$, P2(fuqia e motorit) jo me shume se 5.5 kW, Diametri thithjes $2''$, diametri i dergimit $1 \frac{1}{2}''$, $U = 380 \text{ V}$, Manastir.
- Elektropompe horizontale/vertikale, $Q = 135 \text{ m}^3/\text{h}$, $H = 60 \text{ m}$, P2(fuqia e motorit) jo me shume se 45 kW, Diametri i flanxhes ne thithje DN = 100, Diametri i flanxhes ne dergim DN = 80, PN16, $U = 380 \text{ V}$, Qafa e Hartes
- Elektropompe vertikale $Q = 120 \text{ m}^3/\text{h}$, $H = 110 \text{ m}$, P2(fuqia e motorit) jo me shume se 45 kW, Diametri i flanxhes ne thithje DN = 125, Diametri i flanxhes ne dergim DN = 125, PN 16, $U = 380 \text{ V}$, Lekures
- Elektropompe zhytесе, $Q = 14 \text{ m}^3/\text{h}$, $H = 200 \text{ m}$, P2(fuqia e motorit) jo me shume se 18.5 kW, Diametri i lidhjes me tubacionin $D = 3''$ (inch, tipi i lidhjes Rp), Diametri maksimal jo me i madh se $6''$ (inch), $U = 380 \text{ V}$, Dhrovjan
- Elektropompe horizontale/vertikale , $6.3 \text{ m}^3/\text{h}$, 450 m, P2(fuqia e motorit) jo me shume se 37 kW, Diametri i flanxhes ne thithje DN = 100, Diametri i flanxhes ne dergim DN = 80, PN 63, $U = 380 \text{ V}$ Muzine
- Elektropompe horizontale/vertikale, $Q = 20 \text{ m}^3/\text{h}$, $H = 90 \text{ m}$, P2(fuqia e motorit) jo me shume se 22 kW, Diametri i flanxhes ne thithje DN = 65, Diametri i flanxhes ne dergim DN = 40, PN 16, $U = 380 \text{ V}$, Pece
- Elektropompe zhytесе, $Q = 25 \text{ m}^3/\text{h}$, $H = 150 \text{ m}$, P2(fuqia e motorit) jo me shume se 18.5 kW, Diametri i lidhjes me tubacionin $D = 3''$ (inch, tipi i lidhjes Rp), Diametri maksimal jo me i madh se $6''$ (inch), $U = 380 \text{ V}$, Karahaxh
- Elektropompe zhytесе, $Q = 12 \text{ m}^3/\text{h}$, $H = 110 \text{ m}$, P2(fuqia e motorit) jo me shume se 11 kW, Diametri i lidhjes me tubacionin $D = 3''$ (inch, tipi i lidhjes Rp), Diametri maksimal jo me i madh se $6''$ (inch), $U = 380 \text{ V}$, Livine
- Elektropompe zhytесе, $Q = 14 \text{ m}^3/\text{h}$, $H = 150 \text{ m}$, P2(fuqia e motorit) jo me shume se 13 kW, Diametri i lidhjes me tubacionin $D = 3''$ (inch, tipi i lidhjes Rp), Diametri maksimal jo me i madh se $6''$ (inch), $U = 380 \text{ V}$, Kostar

- Elektropompe zhytëse, $Q = 14 \text{ m}^3/\text{h}$, $H = 160 \text{ m}$, P2(fuqia e motorit) jo me shume se 13 kW, Diametri i lidhjes me tubacionin $D = 3''$ (inch, tipi i lidhjes Rp), Diametri maksimal jo me i madh se $6''$ (inch), $U = 380 \text{ V}$, Vllahat
- Elektropompe horizontale/vertikale, $Q = 15 \text{ m}^3/\text{h}$, $H = 150 \text{ m}$, P2(fuqia e motorit) jo me shume se 30 kW, Diametri i flanxhes ne thithje $DN = 50$, Diametri i flanxhes ne dergim $DN = 50$, PN 25, $U = 380 \text{ V}$, Fushe Verri
- Elektropompe horizontale/vertikale, $Q = 15 \text{ m}^3/\text{h}$, $H = 150 \text{ m}$, P2(fuqia e motorit) jo me shume se 30 kW, Diametri i flanxhes ne thithje $DN = 50$, Diametri i flanxhes ne dergim $DN = 50$, PN 25, $U = 380 \text{ V}$, Vergo
- Elektropompe zhytëse, $Q = 13 \text{ m}^3/\text{h}$, $H = 100 \text{ m}$, P2(fuqia e motorit) jo me shume se 11 kW, Diametri i lidhjes me tubacionin $D = 3''$ (inch, tipi i lidhjes Rp), Diametri maksimal jo me i madh se $6''$ (inch), $U = 380 \text{ V}$, Rusan
- Elektropompe horizontale/vertikale, $Q = 13 \text{ m}^3/\text{h}$, $H = 180 \text{ m}$, P2(fuqia e motorit) jo me shume se 11 kW, Diametri i flanxhes ne thithje $DN = 50$, Diametri i flanxhes ne dergim $DN = 50$, PN 25, $U = 380 \text{ V}$, Kroj
- Elektropompe horizontale/vertikale, $Q = 45 \text{ m}^3/\text{h}$, $H = 120 \text{ m}$, P2(fuqia e motorit) jo me shume se 45 kW, Diametri i flanxhes ne thithje $DN = 65$, Diametri i flanxhes ne dergim $DN = 40$, PN 16, $U = 380 \text{ V}$, Shkalle
- Elektropompe horizontale/vertikale, $Q = 7 \text{ m}^3/\text{h}$, $H = 250 \text{ m}$, P2(fuqia e motorit) jo me shume se 11 kW, Diametri i flanxhes ne thithje $DN = 50$, Diametri i flanxhes ne dergim $DN = 50$, PN 25, $U = 380 \text{ V}$, Markat
- Elektropompe vertikale $Q = 11 \text{ m}^3/\text{h}$, $H = 195 \text{ m}$, P2(fuqia e motorit) jo me shume se 15 kW, Diametri i flanxhes ne thithje $DN = 50$, Diametri i flanxhes ne dergim $DN = 50$, PN 25, $U = 380 \text{ V}$, Konispol
- Elektropompe zhytëse per ujra te ndotur, $Q = 250 \text{ m}^3/\text{h}$, $H = 30 \text{ m}$, P2 (fuqia e motorit) jo me shume se 37 kW, Diametri i flanxhes ne thithje dhe dergim $DN = 150$, $U = 380 \text{ V}$, Sarande
- Elektropompe zhytëse per ujra te ndotur, $Q = 475 \text{ m}^3/\text{h}$, $H = 60 \text{ m}$, P2 (fuqia e motorit) jo me shume se 155 kW, Diametri i flanxhes ne dergim $DN = 200$, $U = 380 \text{ V}$, Sarande
- Mallrat do te sillen ne ambientet e Shoqerise Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sarande, nga operatori ekonomik, ku pas marrjes ne dorezim, do te magazinohen.
- Afati i levrimit te mallrave do te jete jo me shume se 8 jave, nga data e lidhjes se kontrates.

- Te gjitha elektropompat do te shoqerohen me manualet perkatese, te te dhenave teknike,operimit mirembajtjes dhe instalimit.
- Te gjitha elektropompat do te jene te jene te pajisura me certifikaten e aprovimit per perdorim ne ujin e pijshem sipas standarteve kombetare ose nderkombetare
- Materialet e elektropompave do te jene te certifikuara sipas standarteve kombetare SSH ,nderkombetare ISO, EN,DIN,AISI,IEC,etj, dhe ekuivalente me to.
- Te gjitha elektropompat do te shoqerohen me certifikatat perkatese te garancise, e cila(garancia) do te jete **1 vit**, nga data e dorezimit.

Specifikimet teknike jane hartuar dhe argumentuar nga specialistet e fushes.

Në të gjitha rastet kur përmendet certifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

NJESIA E PROKURIMIT